



10/04/2025

Drejtoria Vendore E Policisë Tiranë, Gjatë 24 Orëve Të Fundit

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve arrestuan shtetasit:

- A. Ç., 30 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja” i gjetën një sasi Kokaine;
- E. Gj., 24 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja” i gjetën një sasi Cannabisi;
- E. D., 40 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 i gjetën një sasi Kokaine.

Lëndët narkotike u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Kibernetike referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasen D. B., 34 vjeçe, pasi dyshohet se ka shqetësuar një 32-vjeçare, me mesazhe në rrjete sociale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit:

- P. M., 51 vjeç, A. S., 59 vjeç dhe Ç. H., 55 vjeç, pasi dyshohet se për motive të dobëta, janë konfliktuar fizikisht, me njëri-tjetrin;
- O. Dh., 53 vjeç, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me send të fortë, një 39-vjeçar.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 3:

- arrestuan shtetasin A. K., 29 vjeç, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur me mjet prerës, një 40-vjeçar;
- referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit A. L., 50 vjeç dhe H. C., 58 vjeç, pasi dyshohet se për motive të dobëta, kanë kanosur njëri-tjetrin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 referuan materialet në Prokurori, për shtetasin Sh. A., 37 vjeç, pasi dyshohet se ka kanosur një 46-vjeçar, me armën e zjarrit të cilën e posedonte me leje. Për këtë rast, pas konsultimit me prokurorin, u vendos procedimi në gjendje të lirë i 37-vjeçarit, për veprën penale “Kanosja”. Gjithashtu, arma e zjarrit u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Krujë arrestuan shtetasin E. S., 39 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur.

Specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan shtetasin S. S., 59 vjeç, pasi dyshohet se ka humbur kontrollin mbi automjetin që e drejtonte në gjendje të dehur, dhe si pasojë automjeti ka dalë nga rruga. Nga aksidenti ka patur vetëm dëme materiale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)